

PËRPUNIMI DHE RREGULLIMI I LËNDËS ARKIVORE NË ARKIVIN
NDËRKOMUNAL TË PRIZRENIT

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I HISTORISË – PROGRAMI ARKIVISTIKË

NGA

VALENT QAFLESHI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË – PROGRAMI ARKIVISTIKË

PRISHTINË

TETOR, 2023

PËRPUNIMI DHE RREGULLIMI I LËNDËS ARKIVORE NË ARKIVIN
NDËRKOMUNAL TË PEJËS

Nga

VALENT QAFLESHI

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Muhamet Qerimi

Në këtë punim shkencor do të paraqesim historikun e themelimit të Arkivit Historik të Prizrenit me vonë Arkivi Ndërkomunal i Prizrenit, organizimin dhe veprimtarinë e Arkivit Ndërkomunal të Prizrenit por me theks të veçant për procedurat e përpunimit dhe rregullit të lëndës arkivore në këtë arkiv.

Që kur ka ekzistuar fjala e shkruar, njeriu është ndjerë përgjegjës për ta ruajtur atë dhe për t'ua përcjellë brezave të ardhshëm. Në këtë kuptim, njeriu u përpoq dhe përpiket të zhvillojë tek anëtarët e komunitetit të tij një vetëdije për vlerën e asaj që shkruhet dhe një vetëdije përgjegjësie për gjurmën dhe besueshmërinë e dëshmisë së jetës dhe veprimeve të vetë komunitetit. Nga ana tjetër, nëse dëshiron të fshijë gjurmët e të tjerëve, njeriu gjatë historisë dhe sot përpiket t'i tjetërsojë apo shkatërrojë gjurmët e tij të shkruara siç ndodhi në luftën e Kosovës, ku politika ditore e qeverisë së diktatorit Milosheviq përmes forcave ushtarako-policore shkatërroi çdo gjë kombëtare shqiptare ose i barti në Beograd. E gjithë kjo vlen veçanërisht për ato dokumente që kanë një vlerë të veçantë dhe forcë për të dëshmuar, qoftë për një individ, një komunitet apo një komb.

Qëndrimi pozitiv ndaj fjalës së shkruar me përmbajtje të tillë ka formuar me kalimin e kohës një shërbim dhe veprimtari të veçantë arkivore, e cila në njëqind vitet e fundit është formësuar edhe si disiplinë shkencore edhe si profesion që ka një rol të caktuar në një shoqëri të organizuar.

Arkivat dhe punonjësit e arkivës në kuadrin e punës dhe kujdesit që bëjnë, si në të kaluarën ashtu edhe sot, janë në një masë të madhe vlerësues, përzgjedhës dhe ruajtës të vërtetë të kujtesës së shoqërisë. Me këtë veprim ata krijojnë bazën për formimin e imazhit të një periudhe të caktuar kohore, sepse me një qasje selektive zgjedhin dhe ruajnë, pra nxjerrin dhe shkatërrojnë dokumente dhe informacione për atë kohë. Kështu, ato prekin popullatën e

përgjithshme, të gjithë komunitetin dhe marrëdhënien e tij me historinë. Në këtë kuptim, përgjegjësia e tyre për imazhin e bashkësisë shoqërore, pra edhe për të ardhmen e saj, e cila është ndërtuar mbi rrënjët e së shkuarës dhe skenës së të tashmes, është shumë e madhe.

Edhe arkivi Ndërkomunal i Prizrenit është trashëgimi, koleksion i materialeve arkivore dhe regjistruese të fondeve institucionale e personale dhe përfshijnë materiale nga trashëgimia e shkencëtarëve, historianëve dhe studiuesve të shquar të artit që kanë qenë punonjës dhe bashkëpunëtorë të Institutit, ose trashëgimitë e të cilëve i janë dorëzuar Institutit për ruajtje, mbrojtjen, përpunimin dhe menaxhimin me kontratë dhuratë.

Punimi i Masterit me titull: “Përpunimi dhe rregullimi i lëndës arkivore të Arkivit ndërkomunal të Prizrenit” përbëhet prej:

- Falënderimeve,
- Abstraktit,
- Hyrjes,
- tre (3) kapitujve,
- përfundimeve dhe
- bibliografisë

Hyrje do të pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur e shkurtimisht përmbajta e temës, “Përpunimi dhe rregullimi i lëndës arkivore në Arkivin Ndërkomunal të Prizrenit”, të cilën do ta paraqesim më poshtë, ka ardhur si përmbushje e një detyrimi që çdokush në vendin tim, ia ka borxh qytetit rajonit të tij. Zgjedhja ime për t’u përqendruar në këtë temë ka të bëjë me mundësinë të shfrytëzohet e të njihem me materiale që kam mbledhur gjatë punës sime disa mujore dhe gjatë praktikës që kam bërë në këtë Arkiv Ndërkomunal të Prizrenit.

Në **Kapitullin e parë** do të paraqes në mënyrë të detajuar dhe argumentuar me dokumente si Vendimi i themelimit të Arkivit të Prizrenit, historikun e grumbullimit të fondeve të para, lokalitetet e arkivit që disa herë ka ndërrua lokacion, për punonjësit që bëjnë pjesë në këtë arkiv etj.

Po jap disa tituj që do të trajtohen e sheshohen në këtë kapitull:

- Krijimi i Arkivit të Kosovës
- Arkivat Ndër Komunal të Agjencisë Shtetëror të Arkivave të Kosovës (ASHAK)

- Historiku i themelimit fillimisht të Arkivit Historik të Prizrenit më vonë të Arkivit Ndër Komunal të Prizrenit
- Kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit
 - Sektori Etnologjik i Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit
 - Galeria e Arteve të Kompleksit të Lidhjes
 - Muzeu i Kompleksit monumental të lidhjes (ku janë të ekspozuara edhe të gjitha dokumentet e kësaj ngjarje të rëndësishme historike

Në fokus të **Kapitullit të Dytë**, do të jetë qëllimi, veprimtaria dhe shërbimet e Arkivit Ndërkomunal të Prizren.

Stafi i këtij arkivi bënë përpjekje të mëdha për mbrojtjen, veçanërisht kur bëhet fjalë për lëndën arkivore me vlerë të rëndësishme historike, administrative, juridike, personale e familjare, si parakusht kryesore që më vonë të shfrytëzohet nga qytetarët dhe hulumtuesit shkencor.

1. Fillimisht do të trajtohet, Qëllimi i themelimit të Arkivit (Historik) Ndërkomunal të Prizrenit
2. Pastaj veprimtaria dhe shërbimet e Arkivit Ndërkomunal të Prizrenit, të cilat janë:
 - Shërbimi i mbrojtjes së lëndës arkivore jashtë arkivit (Shërbimi i jashtëm)
 - Shërbimi i depos (ku 12 depo të këtij arkivi janë në gjendje të mjerueshme, me plot lagështi)
 - Seksioni për rregullimin dhe përpunimin e lëndës arkivore
 - Seksioni për punë të përgjithshme dhe financiare
 - Kuadri arkivor
 - Biblioteka

Kapitulli i tretë- ky kapitull do të shtjellon përpunimin dhe rregullimin e lëndës arkivore për të cilën procedurë është nxjerr edhe “Udhëzuesi metodik për rregullimin e lëndës arkivore”, bazuar në Rregulloren për normat e punës janë paraparë detyrat e punës që duhen kryer gjatë përpunimit dhe rregullimit të lëndës arkivore.

Përpunimin e lëndës arkivore, në disa vende përdoret edhe nocioni përshkrim i lëndës arkivore. Përshkrimi në punën profesionale të lëndës arkivore me të cilën fitohen njësitë e përshkrimit, përkatësisht mjetet informative për kërkim, të cilat tregojnë përmbajtjen, qëllimin, periudhën kohore të lëndës arkivore. Në kontekstin tjetër përshkrim arkivor nënkuptojmë përpilimin e përshkrimeve precize të njësisive arkivore duke shënuar informata që shërbejnë për njohjen,

përdorimin, gjetjen dhe shpjegimet e lëndës arkivore dhe kontekstit të sistemit që e ka krijuar atë.

Rregullimi i lëndës arkivore, si në të gjitha arkivat e Kosovës edhe në arkivin Ndërkomunal të Prizrenit, ndiçen procedura e rregullimit të materialit arkivor të grumbulluar (sjell) nga komunat përkatëse. Qëllimi i kësaj pune është që sa më konkretisht të përcaktohet dhe përshkruhet gjendja e lëndës, se çka do të lehtëson prurjen e vendimit për mënyrën dhe planin e rregullimit. Para me rregullimin e lëndës arkivore, behet ndarja e lëndës në fonde që është procedurë standarde e zyrtarëve arkivor.

Lënda arkivore në institucionet arkivore rregullohet dhe përpunohet sipas fondeve (Fondi arkivor është një grup koleksionesh arkivore, pavarësisht nga forma ose baza e tyre, të cilat janë krijuar ose pranuar dhe përdorur nga një person fizik ose juridik në kryerjen e veprimtarive të tyre). Në Arkivin Ndërkomunal të Prizrenit janë përpunuar dhe rregulluar 66 fonde, ku në këtë punim do të jepet një shembull konkret, Fondi i Arsimit gjatë Mbretërisë Shqiptare (1941-1944).